

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE**  
**"GREEN GRAPHICS STUDIO" SH.P.K**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e themelimit, emri dhe themeluesit**

1.1 Sot, me 11/01/2021 (dymije e njetete e nje), une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **"GREEN GRAPHICS STUDIO" SH.P.K.**

1.2 Themeluesi i shoqerise eshte:

- **Sabri Osma**, shtetas shqiptar, i biri i Bashkim dhe Shpresa, lindur me 13.04.1978, ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal H80413059P, banues ne adresen Rr. e "Elbasanit", Nr. 373/1, Tirane, Shqiperi.

**Neni 2**  
**Objekti i veprimtarise**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Studime, projektme dhe zbatime ne fushen e pyjeve dhe kullotave;
- Studime, projektme dhe zbatime ne fushen e mjedisit, bujqesise, social-ekonomike, territorit, infrastruktures etj.;
- Vleresime te ndikimit ne mjedis;
- Studime dhe projektme ne fushen e gjelberimit urban;
- Studime pedologjike, te flores dhe faunes;
- Kontroll dhe supervizim punimesh;
- Sherbime konsulence dhe ekspertize;
- Veleresim te pasurive te paluajtshme.



**Neni 3**  
**Selia dhe kohezgjatja**

3.1 Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. "Marko Bocari, Pallati "TID", Shkalla 1, Apartamenti 3, Tirane, Shqiperi.

3.2 Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe eshte i pakufizuar.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 4**  
**Kapitali themeltar**

4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **100 000 (njqind mije) Leke**.

4.2 Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- Ortaku themelues **Sabri Osma** zoteron **1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100 000 (njqind mije) Lek** qe perben **100 % te kapitalit themeltar te shoqerise**.

4.3 Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

**Neni 5**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

5.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

5.2 Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

5.3 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

5.4 Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



## **Neni 6**

### **Transferimi i kapitalit**

6.1 Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

6.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

6.3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## **Neni 7**

### **Organi vendimmarres**

7.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

7.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.3 Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

7.4 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

7.5 Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

### **Neni 8**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

8.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

8.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

### **Neni 9**

#### **Kuorumi**

9.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

9.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

9.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.



## **Neni 10**

### **Marrja e vendimeve**

10.1 Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

10.2 Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

10.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni 11**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

11.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

11.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## **Neni 12**

### **Administrimi**

12.1 Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesiteje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



12.2 Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

12.3 Administratori i Shoqërise "GREEN GRAPHICS STUDIO" Sh.p.k do te jete **z. Sabri Osma**, shtetas shqiptar, i biri i Bashkim dhe Shpresa, lindur me 13.04.1978, ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal H80413059P, banues ne adresen Rr. e "Elbasanit", Nr. 373/1, Tirane, Shqiperi.

### Neni 13

#### Kompetencat e Administratoreve

13.1 Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- gj) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

13.2 Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- b) shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- c) shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.



13.3 Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

13.4 Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marrëdhënieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësia e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.2 Pervec sa është parashikuar ne dispozitat e përgjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me përgjegjesi çështjet, per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.3 Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, përgjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirebesim.

15.4 Nëse administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 15.1 e 15.2 te ketij neni, është i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parreguilta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja është kryer nga me shume se nje administrator, ata përgjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4 Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:



- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

15.5 Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

15.5 Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

##### **Neni 16 Viti financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 Ekspertet**

17.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2 Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.





**KREU V**  
**PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper". Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjerdjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentari.

18.4 Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

**Neni 20**  
**Baza ligjore**

20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacioneve shqiptar.

20.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



**Neni 21**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU THEMELUES**  
**I SHOQERISE TREGTARE**  
**"GREEN GRAPHICS STUDIO" SH.P.K**

Sabri Osma

Sabri Osma

